



A.nr.53/2025

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)**, i përbërë nga gjyqtarët, Ramush Bardiqi kryesues, Hidajete Gashi Alaj, dhe Kujtim Pasuli anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Goran Marinković përfaqësuesi i iniciativës politike Kosovski Savez, e paraqitur kundër vendimit të Komisioni Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me Nr.01/976-2025, të datës 08.05.2025, lidhur me refuzimin e kërkesës për regjistrimin si parti politike në KQZ të iniciativës politike Kosovski Savez, në seancën e panelit të mbajtur me datë 15.05.2025, merr këtë:

## V E N D I M

**APROVOHET** e bazuar ankesa e përfaqësuesit të iniciativës politike “Kosovski Savez” Goran Marinković, e paraqitur kundër vendimit të Komisioni Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me Nr. 01/976-2025, të datës 08.05.2025, me të cilin i është refuzuar kërkesa për regjistrim si parti politike në Komisioni Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) iniciativës politike “Kosovski Savez”, **NDRYSHOHET** Vendimi i Komisionit Qendror Zgjedhor (KQZ), me Nr. 01/976-2025, i datës 08.05.2025, **PRANOHET** Rekomandimi i Zyrës për Regjistrim, Çertifikimin dhe Kontrollin Financiar të subjekteve politike në KQZ-së i datës 08.05.2025 për Regjistrimin e iniciativës politike “Kosovski Savez” **OBLIGOHET** Zyra për Regjistrim, Çertifikimin dhe Kontrollin Financiar të subjekteve politike në KQZ-së të regjistrojnë iniciativën politike “Kosovski Savez”, si parti politike, dhe të përfshihet në regjistrin e partive politike të regjistruar në Republikën e Kosovës.

## A r s y e t i m

Me datën 12.05.2025 PZAP ka pranuar ankesën e paraqitur nga Goran Marinković përfaqësuesi i iniciativës politike Kosovski Savez, në të cilën thekson se me datë 07.04.2025 kanë dorëzuar në KQZ kërkesë për regjistrimin e iniciativës politike Kosovski Savez, ku gjatë kontrollimit të dokumentacionit, statutit, programit, i njëjti thekson se KQZ ka vërejtur se ekzistojnë disa lëshime në statut. Parashtresuesi i ankesës thekson se të gjitha lëshime i kanë larguar me kohë dhe në afatin të cilin e kanë pasur, për të cilën thekson se kanë bashkangjitur edhe dokumentacionin dhe mesazhet elektronike. Më tutje në ankesë theksohet se me datë 08.05.2025 kanë pranuar vendimin e KQZ-së se regjistrimi i partisë politike Kosovski Savez ishte refuzuar, dhe se në bazë të arsyetimit të cilin e kanë pranuar nuk ka konkluzione konkrete përse ishte refuzuar regjistrimi i partisë Kosovski Savez.

Parashtruesi i ankesës kërkon nga Paneli që ta shqyrtojë edhe një herë kërkesën për regjistrimin dhe që ta regjistrojë partinë politike Kosovski Savez. Si dëshmi ka bashkangjitur kërkesës i kemi dorëzuar edhe.

Si dëshmi kanë bashkangjitur shtojcat: vendimi i KQZ, Nr. 01/976-2025, i datës 08.05.2025, të gjithë dokumentacionin dhe komunikimin me zyrën për regjistrim në KQZ-së.

Në përgjigjen në ankesë, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, sqaron gjithë ecurinë e procesit të zhvilluar nga ana e saj duke theksuar me datë 07.04.2025, iniciativa politike e quajtur "Kosovski Savez" me akronimin IKS, e cila udhëhiqet nga z. Goran Marinković, ka dorëzuar aplikacionin për regjistrim, duke i bashkëngjitur dokumentet e kërkuara sipas Rregullores Nr. 01/2024 Regjistrimi dhe Funksionimin e Partive Politike, të specifikuara në nenin 2, paragrafët 1 dhe 2 që përfshijnë: Aplikacionin e plotësuar, Statutin e partisë, çfarëdo shkurtese apo shenje të partisë, deklaratën e fundit financiare të partisë, aktin e themelimit të partisë, listën me të dhënat dhe nënshkrimet e 500 (pesëqind) përkrahësve për regjistrimin e partisë

Pas pranimit të aplikacionit për regjistrim të iniciativës politike, Zyra ka shqyrtuar dhe verifikuar të gjithë dokumentacionin lartcekur. Në mënyrë që të verifikohet nëse dokumentacioni plotëson kërkesat sipas Rregullores Nr. 01/2024 Regjistrimi dhe Funksionimin e Partive Politike, Zyra ndërmerr hapat si në vijim: Aplikacioni kontrollohet nëse është i plotësuar me të gjitha të dhënat që kërkojnë; Statuti i partisë kontrollohet nëse i është përmbajtur kërkesave që dalin nga neni 11 i Rregullores Nr. 01/2024 Regjistrimi dhe Funksionimin e Partive Politike si dhe nëse përmban elemente të cilat janë të definuar në nenin 4 të Rregullores 01/2024 Regjistrimi dhe Funksionimin e Partive Politike; Shkurtesa apo shenja e partisë e dorëzuar me rastin e aplikimit për regjistrim kontrollohet nëse përmban elemente të cilat janë të definuar në nenin pikën 1.2 të paragrafit 1 të nenit 4 të Rregullores 01/2024 Regjistrimin dhe Funksionimin e Partive Politike, Deklarata e fundit financiare kontrollohet nëse përfshin të gjitha elementet e financimit të iniciativës për themelimin të partisë; Akti i themelimit kontrollohet duke verifikuar në bashkëpunim me Sekretariatën e KQZ-së, nëse të gjithë themeluesit e partisë janë votues në Republikën e Kosovës, dhe nëse janë pjesë e ndonjë partie tjetër të regjistruar në Republikën e Kosovës; listën me të dhënat dhe nënshkrimet e 500 (pesëqind) përkrahësve për regjistrimin e partisë kontrollohet duke verifikuar në bashkëpunim me KQZ, nëse të gjithë përkrahësit për themelimin e partisë janë votues në Republikën e Kosovës. Pas kontrollimit të nevojshëm të këtyre dokumenteve, Zyra ka komunikuar me palët, duke i dërguar shkresë që përmbante komentet për ndryshim. Iniciativës politike i është dhënë afat prej pesë (5) ditësh për të dërguar ndryshimet. Para përfundimit të këtij afati, iniciativa politike ka aplikuar ndryshimet e kërkuara dhe ka dorëzuar materialet në Zyrë.

Zyra ka pranuar fletëtransferin e mjeteve që përbejnë taksën e regjistrimit në vlerën prej 500 euro. Pas verifikimit përfundimtar të të gjitha dokumenteve që kërkojnë për regjistrimin e iniciativës politike si parti politike, Zyra ka shpallur për shqyrtim publik, në faqen zyrtare të KQZ-së, kërkesën e kësaj iniciative politike, nga data 23.04.2025 deri me 29.04.2025. Gjatë periudhës së shqyrtimit publik, Zyra nuk ka pranuar asnjë ankesë në lidhje me aplikimin për regjistrim të politike "Kosovski Savez".

Andaj, pasi që i gjithë dokumentacioni i dorëzuar është në përputhje me nenin 13, paragrafi 4 të LZP dhe neni 2 të Rregullës Nr. 01/2024 Regjistrimi dhe Funksionimin e Partive Politike. Zyra i ka rekomanduar Komisionit Qendror të Zgjedhjeve aprovimin e kërkesës për regjistrim të partisë politike "Kosovski Savez". Pika për shqyrtimin e kërkesës për regjistrim të iniciativës politike në fjalë është përfshirë në rendin e ditës të takimit të KQZ të datës 08.05.2025. Pas diskutimeve lidhur me këtë rekomandim, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka zhvilluar proces votimi ku rekomandimi për regjistrimin e iniciativës politike Kosovski Savez nuk ka marrë 2/3 e votave të Komisionit që kërkohen për regjistrimin e partisë politike. Nga gjithsej 11 (njëmbëdhjetë) anëtarë të Komisionit, 9 (nëntë) anëtar ishin të pranishëm në takim, nga të cilët 5 (pesë) anëtar votuan për ndërsa 4 (katër) abstenuan. Duke marrë parasysh procesin e diskutimit dhe votimit që ka rezultuar me vota të pamjaftueshme për regjistrim të partisë politike, rrjedhimisht është refuzuar rekomandimi i Zyrës, për arsye se në programin dhe statutin e kësaj iniciative politike nuk përshihet emërtimi kushtetues Republika e Kosovës, siç referohet në Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa – PZAP-i, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe pas administrimit të pretendimeve ankimore, dhe përgjigjes në ankesë të KQZ gjeti se:

#### **Ankesa është e bazuar**

Nga shqyrtimi i shkresave të lëndës rezulton se iniciativa politike Kosovski Savez, ka përfunduar aplikimin për regjistrim si parti politike në Zyrën për Regjistrim, Certifikimin dhe Kontrollin Financiar të subjekteve politike në KQZ. Sipas rekomandimit të datës 08.05.2025 të Zyrës së lartcekur, është rekomanduar se iniciativa politike Kosovski Savez i ka plotësuar kushtet ligjore për tu regjistruar si parti politike në KQZ. Në mbledhjen e mbajtur me datë 08.05.2025, pas diskutimeve lidhur me këtë rekomandim, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka zhvilluar proces votimi ku rekomandimi për regjistrimin e iniciativës politike Kosovski Savez nuk ka marrë 2/3 e votave të Komisionit që kërkohen për regjistrimin e partisë politike, ku nga gjithsej 11 (njëmbëdhjetë) anëtarë të Komisionit, 9 (nëntë) anëtar ishin të pranishëm në takim, nga të cilët 5 (pesë) anëtar votuan për ndërsa 4 (katër) abstenuan. Duke marrë parasysh procesin e diskutimit dhe votimit që ka rezultuar me vota të pamjaftueshme për regjistrim të partisë politike, është refuzuar rekomandimi i Zyrës, për arsye se në programin dhe statutin e kësaj iniciative politike nuk përshihet emërtimi kushtetues Republika e Kosovës, siç referohet në Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Me dispozitat e nenit 13 par. 4 i LZP-së parasheh se *“Aplikimet për regjistrimin e partive politike dorëzohen në formën e vendosur nga rregullat e KQZ-së siç kërkohet nga Zyra.....”*. Neni 13 par. 5 i LZP-së parasheh se *“Zyra i shqyrton aplikimet brenda dhjetë (10) ditëve nga pranimi i tyre dhe brenda pesë (5) ditëve nga përfundimi i rishikimit të çfarëdo çështje që kërkon sqarim apo ndryshim në formën e aplikimit”*. Neni 13 par 6 i LZP-së parasheh se *“brenda tridhjetë (30) ditëve nga pranimi i aplikimit, Zyra e njofton KQZ-në për statusin e aplikimit, duke rekomanduar regjistrimin, duke rekomanduar mos regjistrimin, ose duke saktësuar fusha tjera që mund të kërkojnë sqarime shtesë.*

Paneli, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, qëndrimin dhe përfundimin e KQZ-së, të përshkruar si në vendimin e datës 08.05.2025, nuk mund ta pranoi si të drejt dhe të ligjshëm një qëndrim të tillë është në kundërshtim me dispozitat ligjore që i referohen aplikimit dhe

regjistrimit të partive politike. Këtu shtu faktin se, edhe vetë Zyra për Regjistrim i ka rekomanduar KQZ-së aprovimin e kërkesës për regjistrim të partisë politike "Kosovski Savez" pasi që i gjithë dokumentacioni i dorëzuar është në përputhje me nenin 13, paragrafi 4 të LZP dhe neni 2 të Rregullës Nr. 01/2024 Regjistrimi dhe Funksionimin e Partive Politike, ku shprehimisht parashihen kushtet dhe kriteret për regjistrimin dhe funksionimin e partive politike.

Në rastin konkret Paneli vërtetohet se iniciativa politike Kosovski Savez, ka dorëzuar aplikimin e kompletuar, në përputhshmëri bazuar në nenin 13 paragrafi 4 i LZP-së, dhe nenin 2 të Rregullës Nr. 01/2024 për Regjistrimin dhe Funksionimin e Partive Politike, dhe KQZ-ja është e obliguar që të regjistrojë çdo parti politike i cili i plotëson kushtet e parapara ligjore siç i ka plotësuar në rastin konkret iniciativa politike Kosovski Savez, për çka e njëjta është rekomanduar për regjistrim edhe nga Zyra për Regjistrim, Çertifikimin dhe Kontrollin Financiar të Subjekteve Politike në KQZ. Vendimi i atakuar nuk përmban asnjë arsye për refuzim të regjistrimit të subjektit politikë, në pikëpamje të kushteve ligjore të cilat duhet t'i plotësojë një subjekt politik për tu regjistruar edhe pse mekanizmi i brendshëm i KQZ ka rekomanduar se subjekti që ka aplikuar për tu regjistruar ka plotësuar të gjitha kushtet ligjore. Në rrethana të tilla është plotësisht e pa qartë se cili është roli i KQZ përballë rekomandimit pozitiv për plotësim të kushteve ligjore për regjistrim të një subjekti politikë. Pra vendosjes në këtë rast duhet të varë nga vullneti i anëtarëve apo është obligim që vendosja t'i referohet raportit dhe kriterëve të përcaktuara ligjore për regjistrim të subjekteve politike, përkatësisht të ketë vlerësim në pikëpamje të kushteve dhe kriterëve ligjore që është vlerësuar nga mekanizmi i brendshëm se janë plotësuar për regjistrim dhe në këtë aspekt të ipen vlerësimet në vendimin që vendoset për regjistrim të subjektit politik.

Paneli vlerëson se në vendimi e ankimuar të KQZ-së nuk janë dhënë asnjë arsye se perse është refuzuar rekomandimi për regjistrimin e iniciativës politike Kosovski Savez. Arsyetimi i vendimit të atakuar është i mangët, jo i plotë dhe nuk i ka elaboruar të gjitha çështjet dhe faktet vendimtare që kanë të bëjnë me këtë çështje administrative, sa i përket refuzimit të kërkesës për regjistrim e iniciativës politike Kosovski Savez. Vendimi i kontestuar nuk përmban një vlerësim të fakteve në raport me dispozitat ligjore, andaj një vendim nuk mund të quhet se është i drejtë dhe i ligjshëm dhe se është marrë me respektimin e dispozitave ligjore të LZP-së dhe Rregullores 01 /2024 Regjistrimin dhe Funksionimin e Partive Politike.

Aktvendimi i kontestuar është përfshirë në shkeljet thelbësore të nenin 48 të dispozitave të Ligjit për Procedurën Administrative. Shkeljet thelbësore të këtyre dispozitave konsistojnë në faktin se me dispozitën e lartcekur është paraparë se akti administrativ, që në këtë rast nënkupton aktvendimin e goditur me ankesë, duhet të përmbajë, paraqitje të shkurtër të kërkesës së palës, shpjegimin e situatës faktike mbi të cilën është marrë vendimi, shkaqet të cilat kanë qenë vendimtare gjatë vlerësimit të provave, bazën ligjore të vendimit dhe arsyen pse është e zbatueshme në rastin konkret, shkaqet për të cilat nuk është pranuar ndonjëri nga pretendimet e palëve, në rastin e ushtrimit të diskrecionit, shpjegimin pse është ushtruar ai në mënyrën dhënë në vendim.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës, garanton të drejtat e grupeve etnike pakicë, përfshirë të drejtën për të formuar parti politike dhe për të marrë pjesë në jetën politike. Sipas nenit 59 të

Kushtetutës, grupeve etnike pakicë u garantohet përfaqësimi në Kuvendin e Kosovës dhe mundësia për të formuar parti politike që përfaqësojnë interesat e tyre. Në përgjithësi, Kosova ofron një kornizë ligjore për të drejtat e grupeve etnike pakicë, përfshirë të drejtën për të formuar parti politike dhe për të marrë pjesë në jetën politike.

Neni 32 i Kushtetutës e Republikës së Kosovës garanton të drejtën për mjete juridike, duke siguruar që çdo person të ketë mundësinë për mbrojtjen të drejtat dhe liritë e tij përmes mjeteve ligjore efektive. Po ashtu edhe në praktiken gjyqësore të GJEDNJ-së, e cila në rastin (Klass V Gjermanisë) në ndër të tjera thuhet se “kur një person konsideron se është paragjykuar përmes një akti për të cilin pretendon se është në kundërshtim me Konventën, ai duhet të ketë në dispozicion një mjet juridik para autoriteteve shtetërore, që do i mundësojë zgjidhjen e kërkesës së tij, ndërsa në nenin 13 të Konventës Evropiane për të drejtat e njeriut ndër të tjera thuhet se “...Çdokush, të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e përcaktuara në këtë Konventë, ka të drejtën e një zgjidhjeje efektive para një organi kombëtar...”.

Ne përfundim, Paneli arsyeton se, në analizë të pretendimeve të ngritura në ankesa, rrethanave të faktit si dhe kritereve të posaçme që kërkon ligji LZP-se, ankimi përmban shkaqe të arsyeshme për aprovim e për të cilën vendimi i ankimit është dashtë të ndryshohet dhe të vendoset si në dispozitiv të këtij vendimi.

Andaj, Paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi konform neneve: 53 paragrafi 3, të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative parasheh se: Anulimi apo shfuqizimi bëhen me një akt të ri me shkrim, i cili anulon, shfuqizon, ndryshon apo plotëson aktin e parë. Ndërsa neni 131 i të njëjtit ligji parasheh se: Kur organi publik kompetent vlerëson se ankesa është e pranueshme dhe e bazuar plotësisht, me një akt të ri administrativ do të anulohet apo ndryshohet aktin e ankimit, gjegjësisht do të lëshohet aktin e refuzuar, siç është kërkuar nga pala.

Në pajtim me nenet 115 par. 1 lidhur me nenin 118 par. 1 dhe 5 të dhe 119 LZP-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi, pasi që Paneli vlerëson se nga dispozitat e lartcekura, rezulton se vendimi i atakuar është në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi për çka vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi, dhe urdhëroi KQZ-në, që të zbatojë vendimin e PZAP-it konform dispozitës së nenit 118 par. 5 të LZP-së.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
A.nr.53/2025, datë; 15.05.2025



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.